
VENDIM EKZEKUTIV NR. 2007/43

**QË PRFUNDON PEZULLIMIN E PRKOHSHM TË VEPRIMIT SIPAS NENIT 17
TË RREGULLORES S UNMIK-UT NR. 2006/50 TË DATS 16 TETOR 2006 MBI
ZGJIDHJEN E KRKESAVE LIDHUR ME PRONN E PALUAJTSHME
PRIVATE, PRFSHIR PRONN BUJQËSORE DHE KOMERCIALE**

Në bazë të kompetencave të dhëna mua si Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) dhe në bazë të Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, të datës 10 qershor 1999 dhe në bazë të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999, sipas ndryshimeve, mbi Kompetencat e Administratës së Përkohshme në Kosovë

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale,

Duke pasur parasysh që në bazë të Nenit 17 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale e cila i ishte besuar Agjencisë Kosovare të Pronës të ushtrrojë kompetencat e ekzekutimit në lidhje me çdo vendim apo urdhër dëbim të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore të Kosovës të cilat akoma nuk janë ekzekutuar,

Me lëshimin e Vendimit Ekzekutiv Nr. 2007/41 duke pezulluar përkohësisht aplikimin e Nenit 17 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale me qëllim të pezullimit të kompetencave të ekzekutimit lidhur me vendimet e caktuara të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPCC),

Duke qenë i kënaqur që uniteti ndërmjet të gjitha grupeve të interesuara përfshirë Qeverinë e Kosovës dhe bashkësinë ndërkombëtare që është i nevojshëm për zbatim të efektshëm të vendimeve relevante të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe Banesore (HPCC) është manifestuar në Takimin e Jashtëzakonshëm të Bordit Mbikqyrës të Agjencisë Kosovare të Pronës më 8 gusht 2007,

Përkthim jo-zyrtar

Me qëllim të përfundimit të pezullimit të përkohshëm të veprimit zbatues sipas mandatit në Vendimin Ekzekutiv Nr. 2007/41 që përkohsisht pezullon Nenin 17 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50, të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale,

Me anë të kësaj vendoset si në vijim:

Vendim:

Pezullimi i përkohshëm i veprimit sipas Nenit 17 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 i datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale që ka mandat sipas Vendimit Ekzekutiv Nr. 2007/41 që përkohësisht pezullon Nenin 17 të Rregullores së UNMIK-ut Nr.2006/50 të datës 16 tetor 2006 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronën Bujqësore dhe Komerciale përfundon menjëherë pas nënshkrimit të këtij Vendimi.

Nënshkruar më 8 gusht 2007.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

Përkthim jo-zyrtar